

Në bazë të nenit 28, paragrafi 8 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18, 208/24 dhe ---/25) dhe nenit 18 të Statutit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), në seancën e mbajtur më datë 23.01.2025, miratoi këtë:

VENDIM STATUTOR  
PËR NDRYSHIMIN E STATUTIT

TË KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Neni 1

Në Statutin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 01-161/1 të datës 10.07.2019, në nenin 6, në paragrafin (2), pas fjalës “anëtarët”, fjalët: “të angazhuar profesionalisht në punë” shlyhen.

Neni 2

Neni 9, paragrafi (1) ndryshohet dhe thotë:

“Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje përbëhet nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kryetar i Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje është kryetari ose një nga anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe i njëjti detyrimisht duhet të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës”.

Neni 3

Neni 11 ndryshohet dhe thotë:

“(1) Format themelore organizative të shërbimit profesional të Komisionit janë:

1. Këshilltar shtetëror nga fusha e mbrojtjes së konkurrencës.
2. Këshilltar shtetëror për kontrollin e ndihmës shtetërore.
3. Sektori për punë të përgjithshme, profesionale-administrative dhe burime njerëzore:
  - Njësia për punë profesionale-administrative dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;
  - Njësia për mbështetje administrative të punës së komisionit dhe sistemit informatik.
4. Sektori për analiza dhe vlerësim të përqendrimeve:
  - Njësia për hulumtim dhe analizë të tregjeve;
  - Njësia për vlerësimin e përqendrimeve.
5. Sektori për procedura të kundërvajtjes që zhvillohen në pajtim me LMK:
  - Njësia për procedura të kundërvajtjes nga fusha e keqpërdorimit të pozitës dominuese dhe përqendrimeve;
  - Njësia për mbështetje administrative të punës së komisionit dhe sistemit informatik.
6. Sektori për kontrollin e ndihmës shtetërore:
  - Njësia për mbikëqyrje mbi ndihmën shtetërore;
  - Njësia për vlerësimin e ndihmës shtetërore.
7. Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar, ndjekjen dhe zbatimin e së drejtës së BE-së:
  - Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar, ndjekjen dhe zbatimin e së drejtës së BE-së për qëllimet e zbatimit të LMK-së dhe LNPPTZFPBU -së;

- Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar, ndjekjen dhe zbatimin e së drejtës së BE-së për qëllimet e zbatimit të LKNSH-së.
8. Sektori për praktika të padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore:
- Njësia për hulumtime dhe analiza ekonomike për qëllimet e zbatimit të LNPPTZFPBU -së;
  - Njësia për procedura të kundërvajtjes për qëllimet e zbatimit të LNPPTZFPBU -së.
9. Njësia për çështje financiare.

#### Neni 4

Neni 26 ndryshohet dhe thotë:

“Nga mjetet e Komisionit sigurohen mjete veçanërisht për: paga dhe kompensime për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit, paga të të punësuarve në shërbimin profesional të Komisionit, prokurimin e pajisjeve dhe shlyerjen e shpenzimeve materiale për punën e Komisionit, shpenzime udhëtimi në vend dhe jashtë vendit për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit dhe nëpunësit administrativë në shërbimin profesional të Komisionit, pjesëmarrje në punën e organizatave ndërkombëtare, kompensim të bashkëpunëtorëve të jashtëm që nuk janë në marrëdhënie pune në Komision, që janë parashikuar me planin vjetor financiar për vitin aktual.”

#### Neni 5

Në nenin 27, në paragrafin (1), pas fjalës “anëtarët”, fjalët: “që janë të angazhuar profesionalisht në punë”, shlyhen.

Në paragrafin (2), fjalët “të cilët nuk janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit”, shlyhen.

#### Neni 6

Ky Vendim Statutor për ndryshimin e Statutit hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e miratimit të tij.

Numër \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS**  
**KRYETARE**  
**Mr. Malinka Siljanovska Nikoliq**

---